

# Gara për kryeprokuror/ Këshilli i Lartë i Prokurorisë shtyn afatin për të verifikuar katër kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë

POSTED 18/06/2019 KLP



Dje përfundoi afati ligjor për verifikimin e plotësimit të kushteve nga kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm. Për këtë arsye Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka thirrur mbledhjen plenare me objekt “Shqyrtimin e dokumentave të dorëzuara nga kandidatët dhe nga institucionet përkatëse për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”. Kandidatët tashmë kanë dorëzuar dokumentet e nevojshme për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për garën për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

Kryetari i KLP, Gent Ibrahimiu u shpreh se do pritet derisa të përfundojë vettingu për kandidatin Çela për vlerësimin e plotësimit të kriterëve nga ana e kandidatëve.

Në fillim të mbledhjes kreu i KLP Gent Ibrahimiu u shpreh se: “Në rregulloren që miratua në datën 19 mars ne morëm një vendim të rëndësishëm, në disa nene të kësaj rregulloreje ne shprehëm vullnetin e KLP që ata kandidatë që janë ende në proces vettingu nuk do të shqyrtohen derisa të përfundojë ky proces. Më konkretisht zoti Olsian Çela është shortuar nga KPK dhe kanë filluar procedurat për rivlerësimin e zotit Çela. Në datën 8 maj 2019 ne i dërguam një shkresë KPK ku i kërkuam përsheptimin e procedurave të rivlerësimit të zotit Çela. Sidoqoftë sot përfundon afati për shqyrtimin e kandidaturave ende nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit për zotin Çela. Sot jemi të detyruar të shtyjmë afatin dhe projekt vendimin i cili propozon shtyrjen e afatit për kushtet ligjore derisa të përfundojë procesi i rivlerësimit për Olsian Çelan”.

Nga anëtarët e pranishëm u sugjerua se termi “shqyrtim” për kandidatët nuk ishte i duhuri, prandaj u ra dakord se termi më i saktë do ishte ai i “administrimit” të të dhënave të kandidatëve. Vendimi u miratua unanimisht nga anëtarët e KLP.